DRAFT KONTRATË PËR VEPRËN
Nr. ICK CLF 2024/0xx

"Shërbime Mendim Ligjor"

Kjo kontratë është lidhur në Prishtinë, më datë xx.xx.xxxx, në mes të:

Innovation Centre Kosovo (ICK), me numër regjistrimi: 5200246-0 dhe numër fiskal: 600755857, me adresë Rexhep Mala 28A, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga Metihe Kastrati, Drejtoreshë Menaxhuese (mëtutje "Kontraktori")

dhe

Kompanisë xxx me numër të biznesit dhe numër fiskal: xxxxx me adresë Rxxxx, Republika e Kosoves, e përfaqësuar nga xxxxx (mëtutje "Pala e Kontraktuar").

Së bashku të njohura si "Palët Kontraktuese"

Derisa, Pala e Kontaktuar është një ofruese e shërbimeve profesionale për: *Mendim ligjore.*

Kurse, Kontraktori dëshiron që Pala e Kontraktuar të kryej punën e përshkruar në këtë kontratë dhe Pala e Kontraktuar pajtohet që ta kryej një Punë të tillë;

Neni 1. Lënda e Kontratës

1.1. Lënda e Kontratës është kontraktimi i shërbimeve të: **Mendim Ligjor për dy tema** (në vijim "Vepra").

1. Assessment of ICK's current management and supervisory functions/practices with respect to their compliance with ICK's Charter/Statute and Law of NGOs, specifically, and any other applicable laws, in general.
Note: The review should also assess the execution of agreements with external parties, including donors, partners, and the governance of financial management, institutional accounts, and compliance with statutory obligations.

2. Identification of necessary remedial measures.

1.2. Shërbimet e kontraktuara janë të përshkruara detajisht në termat e references, bashkëngjitur me këtë Kontratë si Shtojca 1 e Kontratës.

Neni 2. Çmimi i kontraktuar dhe pagesa

2.1. Vlera totale për shërbimet e kontraktuara që i paguhet Palës së kontraktuar është:**- xxxxx**

2.2. Në rast se Kontraktori kërkon shërbime shtesë / zgjerim shërbimesh nga lista e shërbimeve këtu të Kontratuara, e në lidhje me Veprën e njejtë, të njejtat për qëllime të kompenzimit do të trajtohen si shërbime shtesë. Shërbimet shtesë mund të kompenzohen vetëm pas pëlqimit me shkrim të Kontraktorit në lidhje me ofertën plotësuese financiare për të njejtat. Në mungesë të pëlqimit asnjëra palë nuk ka obligime ndaj tjetrës në lidhje me propozimin për shërbimet shtesë.

2.3. Kontraktori do të paguaj Palën e Kontraktuar në xhirollogarinë bankare të Palës së Kontraktuar 30% me nënshkrim të kontratës dhe 70% me pranim e shërbimeve.

Neni 3. Kohëzgjatja e kontratës

3.1. Kontrata do të hyjë në fuqi nga xxxx.xxxx deri me xxx.xxxx, ndërsa shërbimi fillon menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe duhen të kryhet jo më vonë se xxx.xxxx.

3.2. Pala e Kontraktuar detyrohet që shërbimet e kontraktuara t'i përfundojë dhe t'ia dorëzojë Kontraktorit jo më vonë se xxx xxxx.

3.3. Afati i livërimit mund të pësojë ndryshime dhe shtyhet vetëm në :

i) rrethanat e fuqisë madhore;

ii) pengesat e imponuara jashtë mundësisë së parashikimit, evitimit dhe eliminimit nga ana e Palës së Kontraktuar, e që nuk janë shkaktuar as nga personat e ndërvarur prej tij;

iii) vonesat në dorëzimin e dokumentacionit të detyrueshëm (në rast nevoje) nga ana e Kontraktorit.

3.4. Shtyerja e afateve të kontraktuara, për arsyet nga paragrafi 3 i këtij neni do të konstatohet dhe evidentohet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja Palët.

3.5. Në rast të ndërprerjes së parakohshme të kontratës nga Kontraktoripa arsye, Kontraktori obligohet të paguajë 20% të shumës totale të kontraktuar me këtë kontratë.

Neni 4. Obligimet e Palës së Kontraktuar

4.1. Pala e Kontraktuar obligohet që të kryej punët e Ofertuara sipas rregullave të profesionit dhe të mos bëjë shmangje / devijime nga ToR, që është pjesë përbërëse e Kontratës (të bashkangjitura si Shtojca 1), përpos nëse për këtë autorizohet me shkrim nga Kontraktori. Në të kundërtën, vetë do të bart shpenzimet dhe dëmet e shkaktuara si pasojë e veprimeve në kundërshtim me këtë dispozitë.

4.2. Pala e Kontraktuar detyrohet që të bëjë ndërrimet e kërkuara nga ana e Kontraktorit në afat prej 5 ditë nga dita e pranimit të vërejtjeve . Në të kundërtën do të ndëshkohet përmes ndalesës së pagesës së plotë, apo deri në 15 % të vlerës së çmimit të kontraktuar. Vendimin mbi vlerën e ndalesës së kompenzimit të plotë e merr Kontraktuesi, sipas gjykimit të tij, kurse Pala e Kontraktuar mund të godit vendimin e Kontraktorit në procedurë gjyqësore.

Neni 5. Obligimet e Kontraktorit

5.1. Kontraktori'obligohet që t'i jep udhëzimet e nevojshme Palës së Kontraktuar për qëllime të përfundimit të Veprës/Shërbimeve sipas ToR të dorëzuar dhe ka të drejtë të bëjë mbikqyrjen e punëve gjatë realizimit të tyre.

5.2. Menjëherë pas pranimit të Veprës/Shërbimeve, Kontraktori ka për obligim që të vlerësojë të njejtën dhe vërejtjet eventuale në lidhje me cilësinë e Veprës/Shërbimeve t'i prezantojë jo më vonë se 5 ditë pune pas pranimit të punës.

5.3. Kontraktori ka për obligim që të ofrojë bashkëpunim dhe eliminojë pengesat në anën e tij, të cilat mund të pengojnë Palën e Kontraktuar të përfundojë me kohë Veprën e kontraktuar. Në të kundërtën, Pala e Kontraktuar të lirohet nga detyrimet e pagesës së kamatëvonesës për vonesat e shkaktuara.

5.4. Kontraktori obligohet që të bëjë pagesën e çmimit të kontraktuar në kohën dhe mënyrën e kontraktuar. Mirëpo, ky obligim nuk e kufizon mundësinë e Kontraktorit në zbritjen e çmimit të kontraktuar për shkak të vonesave të Palës së Kontraktuar, apo cilësisë së Veprës, si në mënyrën e kontraktuar me dispozitat e Kontratës.

Neni 6. E drejta e autorësisë mbi Veprën

6.1. E drejta e autorësisë mbi Veprën, në rast të prodhimit të dokumenteve, lëndë e kësaj Kontrate, i takon ekskluzivisht Kontraktorit.

6.2. Pala e Kontraktuar, si autor/e i/e Veprës/Shërbimeve gëzon të drejtën që emri i tij të paraqitet si realizues i Veprës.

Neni 7. Klauzola e konfidencialitetit

7.1. Pala e Kontraktuar obligohet të respektojë fshehtësinë profesionale në raport me Kontraktorin përfshirë informatat në lidhje me aktivitetet afariste të Kontraktorit të mësuara gjatë ekzekutimit të punëve si dhe të gjitha informatat profesionale dhe teknike të Kontraktorit në lidhje me vetë Veprën, lëndë e kësaj Kontrate.

7.2. Dokumentacioni i punës, me të gjitha shënimet e dorëzuara për qëllime të realizimit të Veprës është pronë intelektuale e Kontraktorit dhe Pala e Kontraktuar nuk mund të shfrytëzojë të njejtin për asnjë punë tjetër përpos për ekzekutimin e punëve sipas kësaj Kontrate.

7.3. Shkelja e dispozitave nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni do të rezultojë me kompensim financiar për dëmin e pësuar nga Pala e Kontraktuar.

7.4. Klauzola e konfidencialitetit nuk do të aplikohet në lidhje me informatat të cilat eventualisht kërkohen me urdhër të gjykatës apo me urdhër të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror, mirëpo Kontraktori do të informohet paraprakisht në lidhje me dhënien e një informate të tillë, përpos nëse kjo ndalohet me urdhër gjyqësor.

Neni 8. Forcë Madhore

8.1. Në rast dhe sa më shpejt që të jetë e mundur, pas ndonjë ndodhie si shkak që përbën forcë madhore,, Pala e prekur nga ajo do t'i japë Palës tjetër njoftimin dhe të dhënat e plota me shkrim për këtë ndodhi. Nëse Pala e prekur është bërë e paaftë, tërësisht ose pjesërisht, për të përmbushur detyrimet e saj ose për të përmbushur përgjegjësitë e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, Palët do të konsultohen për veprimet e duhura që duhet të ndërmerren, të cilat mund të përfshijnë përfundimin e kësaj Marrëveshjeje nga ICK në përputhje me Neni 3, ose përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nga Pala e Kontraktuar me të paktën shtatë (7) ditë njoftim me shkrim.

8.2. Forca madhore siç përdoret këtu nënkupton çdo akt të paparashikueshëm dhe të papërmbajtshëm të natyrës, pandemisë, çdo akt lufte (qoftë i deklaruar apo jo), pushtim, revolucion, kryengritje, terrorizëm ose çdo akt tjetër të natyrës ose forcës së ngjashme, me kusht që akte të tilla lindin nga shkaqe jashtë kontrollit dhe pa fajin ose neglizhencën e Palës që thirret në forcën madhore.

Neni 9. Korrupsioni dhe parregullsi të tjera

9.1. Kontraktori do të punojë në mënyrë aktive për të parandaluar korrupsionin dhe parregullsitë e tjera brenda dhe në lidhje me këtë marrëveshje. Ky detyrim zbatohet për të gjithë anëtarët e stafit, konsulentët dhe personelin tjetër jo-staf dhe për palën e kontraktuar dhe përfituesit e tjerë e lidhur me këtë marrëveshje.

9.2. Korrupsioni dhe parregullsitë e tjera i referohen të gjitha llojeve të:

- korrupsioni, duke përfshirë ryshfet, nepotizëm, shpërblime të paligjshme ose forma të tjera të abuzimit të besimit, pushtetit dhe pozitës për përfitime të pahijshme;
- shpërdorimi i parave të gatshme, inventarit dhe të gjitha llojeve të tjera të aseteve;

DRAFT

- pasqyra financiare dhe jofinanciare jo reale;
- Vlerat/shumat e të gjitha shfrytëzimeve të tjera në kuadër të aktiviteteve në lidhje me këtë marrëveshje që nuk janë në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshjeje si dhe TOR.

9.3. Pala e Kontraktuar do të:
- të marrë parasysh rrezikun e korrupsionit dhe parregullsitë e tjera dhe të identifikojë rreziqet kryesore dhe masat për zbutjen e rrezikut. Nëse identifikohet një rrezik i konsiderueshëm i korrupsionit dhe parregullsive të tjera, do të miratohen masa për zbutjen e rrezikut për të zvogëluar rrezikun e identifikuar,
- të organizojë operacionet dhe sistemet e kontrollit të brendshëm në mënyrë që korrupsioni dhe parregullsitë e tjera të parandalohen, menaxhohen dhe zbulohen;
- të bëjë të pamundurën për të parandaluar dhe ndaluar korrupsionin dhe parregullsitë e tjera brenda dhe në lidhje me këtë marrëveshje;
- të kërkojë që i gjithë personeli i përfshirë dhe çdo konsulent, furnizues dhe kontraktor i financuar sipas kësaj marrëveshjeje të përmbahet nga korrupsioni dhe parregullsitë e tjera.

9.4. Pala e Kontraktuar do të informojë menjëherë ICK-në për çdo parregullësi të korrupsionit dhe parregullsive të tjera në lidhje me këtë Marrëveshje në email: info@ickosovo.com; ose telefononi: +383 (0) 38 771 180.

9.5. ICK merr përsipër të hetojë praninë e korrupsionit dhe parregullsive të tjera dhe të ndërmarrë veprime, përfshirë veprimet ligjore, ndaj personave që ka arsye të dyshohet për korrupsion dhe parregullsi të tjera. Kur çështja të jetë përfunduar, ICK-ja do t'ia dorëzojë Bordit të Drejtorit të ICK-së një raport përfundimtar lidhur me korrupsionin e dyshuar dhe parregullsitë e tjerasi dhe do ta informojë Palën e Kontraktuar.

Neni 10. Konfliktet e interesit

10.1. Pala e Kontraktuar do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur çdo konflikt interesi në të gjitha çështjet që lidhen me Marrëveshjen. Pala e Kontraktuar do të sigurojë që stafi i tij, duke përfshirë dhe menaxhmentin e tij, të përfshirë në këtë Marrëveshje të mos i vendosë në një situatë që mund të shkaktojë konflikt interesi.

10.2. Konflikti i interesit i referohet çdo situate ku ushtrimi i paanshëm dhe objektiv i funksioneve të kujtdo që vepron në emër të Palës së Kontraktuar është ose mund të kompromentohet për arsye që përfshijnë familjen, jetën personale, afinitetin politik ose kombëtar, interesin ekonomik ose ndonjë lidhje tjetër. ose interes të përbashkët me një person tjetër.

10.3. Nëse ndodh një konflikt interesi, Pala e Kontraktuar do të njoftojë menjëherë ICK-në për këtë qështje me shkrim dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të zgjidhur konfliktin, p.sh., duke zëvendësuar personin në fjalë ose duke marrë verifikim të pavarur të kushteve të vendimit.

10.4. ICK rezervon të drejtën të verifikojë nëse masat e marra janë të përshtatshme dhe mund të kërkojë marrjen e masave shtesë nëse është e nevojshme.

Neni 11. Qeverisje e mirë

Palët do të mbështesin përpjekjet për të konsoliduar qeverisjen e mirë duke promovuar kulturën dhe praktikat demokratike, duke ndërtuar dhe forcuar qeverisjen e përgjegjshme, transparente dhe të përgjegjshme në të gjitha nivelet dhe duke rrënjosur pluralizmin politik, transparencën dhe tolerancën.

DRAFT

Neni 12. Zgjidhja e kontratës

12.1. Kjo Kontratë mund të zgjidhet para përfundimit të Veprës me marrëveshje të Palëve Kontraktuese.

12.2. Kjo Kontratë mund të zgjidhet nga Kontraktori nëse Pala e Kontraktuar është në vonesë në dorëzimin e Veprës , apo ndryshe dështon të sillet me obligimet e marra këtu. Afati i njoftimit me shkrim për zgjidhje të kontratës sipas këtij paragrafi është 7 ditë kalendarike.

Neni 13. Komunikimi në mes të palëve

13.1. Çdo komunikim në mes të Palëve në lidhje me këtë Kontratë bëhet me shkrim, duhet të përmbajë emërtimin dhe numrin e Kontratës dhe duhet të përcillet me anë të postës elektronike, postës rekomandë apo edhe dorëzimit personal.

13.2. Komunikimet në mes të palëve zhvillohet në adresat në vijim:

Për **Innovation Centre Kosovo (ICK),**
Emri i personit kontaktues: xxx
Adresa e zyres : Rr.Rexhep Mala 28/A
E- mail adresa: xx@ickosovo.com

Për **Kryerësi i shërbimeve**
Emri i personit kontaktues: xxxx
Adresa e zyres:xxxx
E-mail adresa : xxx

13.3. Secila palë është e detyruar që në afat shumë të shkurt të njoftojë palët tjetër për ndryshim të personit të autorizuar, apo të detajeve kontaktuese nga paragrafi 1 i këtij neni. Në të kundërtën mban përgjegjësinë për çdo dëm apo vonesë të shkaktuar për shkak të mos njoftimit me kohë të këtyre ndryshimeve.

Neni 14. Transferimi i të drejtave dhe obligimeve

14.1. Kjo Marrëveshje nuk është e transferueshme nga Pala e Kontraktuar. Shërbimet e rënë dakord këtu lidhen me drejtpërdrejt me Palën e Kontraktuar dhe Pala e Kontrkatuar nuk do të ketë asnjë të drejtë të nënkontraktojë asnjë nga shërbimet që do të ofrohen sipas kësaj Marrëveshjeje.

14.2. Kryerësi i veprës nuk do të transferojë, pengojë sipas dispozitave të kësaj Marrëveshje ose ndonjë pjese të saj, ose ndonjë prej pretendimeve, detyrimeve të të drejtave të Palës së Kontrkatuar sipas kësaj Marrëveshjeje, përveçse me pëlqimin paraprak me shkrim të ICK.

Neni 15. Statusi i Palës se Kontraktuar

15.1. Pala e Kontraktuar është një kontraktues i pavarur dhe në asnjë mënyrë nuk do të pretendojë asnjë të drejtë të punonjësit sipas ligjit të punës, ose të agjentit, partnerit ose bashkëpunëtorit të ICK-së, sipas ndonjë legjislacioni tjetër në fuqi.

15.2. Pala e Kontraktuar nuk do të ketë autoritetin, për të shprehur ose të nënkuptuar, të marrë përsipër ose të krijojë ndonjë detyrim ose përgjegjësi në emër të ICK-së dhe nuk do të ketë autoritetin të përfaqësojë ICK-në në asnjë cilësi tjetër, përveç qëllimeve dhe vetëm nëse dhe siç përcaktohet në këtë Marrëveshje.

DRAFT

Neni 16. Siguria dhe Antiterrorizmi

16.1. Pala e Kontraktuar pranon të ndërmarrë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që asnjë vlerë monetare e pranuar nga ICK-së sipas kësaj Marrëveshjeje të mos përdoret për të ofruar mbështetje për individët ose subjektet e lidhura me terrorizmin.

16.2. Pala e Kontraktuar dhe ICK janë të përkushtuar të ndërmarrin hapat e duhur për të siguruar që shumat e përshkruara sipas kësaj Marrëveshjeje të mos përdoren për të ndihmuar, ose mbështetur në ndonjë formë, terroristët ose organizatat terroriste.

16.3. Pala e Kontraktuar bie dakord që do të përdorë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që shuma e pranuar sipas kësaj Marrëveshjeje të mos përdoret për t'u përfshirë në, mbështetur ose promovuar dhunën, aktivitetin terrorist ose trajnimin përkatës të çfarëdo lloji dhe do të marrë të gjitha masat e duhura dhe do të fillojë të gjitha procedurat e nevojshme për të parandaluar terrorizmin.

16.4. Nëse, gjatë rrjedhës së kësaj Marrëveshjeje, Pala e Kontraktuar zbulon ndonjë lidhje me ndonjë organizatë ose individ të lidhur me terrorizmin, ai duhet të informojë menjëherë ICK-në. Kontraktuesi do t'i japë ICK-së një llogari të të gjitha fakteve të njohura, dhe më pas do të konsultohet vazhdimisht me ICK-në për trajtimin e mëtejshëm të çështjes.

Neni 17. Ligji në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1. Çështjet të cilat nuk janë të rregulluara me këtë Kontratë do të interpretohen në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore.

17.2. Mosmarrëveshjet eventuale ndërmjet palëve lidhur me të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nëse nuk arrihet zgjidhje miqësore brenda 7 ditëve nga data e kontestit të tillë.

Neni 18. Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje, duke përfshirë çdo shtojcë të bashkangjitur, deklaron të gjithë Marrëveshjen midis palëve dhe zëvendëson të gjitha kontratat, propozimet e mëparshme, gojore ose me shkrim, dhe të gjitha komunikimet e tjera ndërmjet Palëve mbi temën e kësaj marrëveshjeje.

Neni 19. Dispozitat përfundimtare

19.1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim, sipas marrëveshjes nga të dyja palët.

19.2. Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe dhe në dy kopje identike; një për secilën palë kontraktuese dhe paraqet shprehje të vullnetit të palëve kontraktuese, të cilat me nënshkrim personal shprehin respektimin e kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Prishtinë, më_____

ICK	**xxxxx**
Kontraktori	**Pala e Kontraktuar**
_____	_____
Emri: Metihe Kastrati	Emri: xxxx
Pozita: Drejtoreshë Menaxhuese	Pozita: xxxx

DRAFT